

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the
General Secretary

Nr. 123/2025
Datë: 09/09/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Funksionimin dhe Organizimin e Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në përputhje me nenin 9, paragrafi 5 të Rregullorës MF-NR.04/2017 mbi Kriteret, Standardet e Financimit Publik të OJQ-ve, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mos përmbushjes së kriterëve procedurale si dhe ankesave ndaj vendimeve për mbështetje financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare nga Ministria e Drejtësisë
2. Komisioni sipas pikës një (1) të këtij vendimi themelohet me mandat dy (2) vjeçar në përbërje prej tre (3) anëtarëve të rregullt dhe një (1) anëtar rezervë, si në vijim:
 - 2.1. Ylfete Abazi, Zyrtare e Lartë për Inspektimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryetare;
 - 2.2. Valmira Uka, Zyrtare e Lartë Ligjore, anëtare;
 - 2.3. Fahrije Ajeti, Zyrtare e Lartë e Shërbimeve Sociale, anëtare
 - 2.4. Ganimete Shala, Zyrtare e Lartë për Trajnime, anëtare rezervë.
3. Komisioni nga pika 2 e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e tij të përcaktuara me Rregulloren MF-NR.04/2017 mbi Kriteret, Standardet e Financimit Publik të OJQ-ve dhe legjislacionit në fuqi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet nr. 48/2023 i datës 03/05/2023, si dhe vendimi me nr. 39/2025 i datës 10/04/2025.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivit të MD-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 39 /2025
Datë: 10/04 /2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në përputhje me nenin 9 (paragrafi 5) të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 48/2023, të datës 03.05.2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2.1 dhe pika 2.3 e Vendimit Nr.48/2023, të datës 03.05.2023, si në vijim:

2.1. *Ylfete Abazi, Zyrtare e Lartë për Inspektim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryetare;*

2.3. *Valmira Uka, Zyrtare e Lartë Ligjore, anëtare.*

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivit të MD-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarës së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 48/2023.
Dt. 03/05/2023.

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, në pajtim me nenin 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe në përputhje me nenin 9 (paragrafi 5) të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Zv. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mos përmbushjes së kriterëve procedurale si dhe ankesave ndaj vendimeve për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare nga Ministria e Drejtësisë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
2. Komisioni sipas pikës një (1) të këtij vendimi themelohet me mandat dy (2) vjeçar, në përbërje të tre (3) anëtarëve të rregullt dhe një (1) anëtar rezervë, si në vijim:

- 2.1. Nafije Selimi, kryetare;
- 2.2. Valbona Mujota, anëtare;
- 2.3. Ardian Mehmeti, anëtar; dhe
- 2.4. Lutfi Bislimi, anëtar rezervë.

3. Komisioni nga pika 2 e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësit e tij të përcaktuara me Rregulloren MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe legjislacionin në fuqi.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD; dhe
- Arkivit të MD-së.